



**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK**

**TREGUESIT STATISTIKORE**  
**TE TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

**6 MUJORI I-rë 2012**

**TELEFONI CELULARE**

**TELEFONI FIKSE**

**INTERNET**

**Shtator 2012**

|  |           |
|--|-----------|
| <b>I.HYRJE</b> .....   | <b>3</b>  |
| <b>II. PANORAME E PERGJITHSHME</b> .....   | <b>4</b>  |
| <b>III. TELEFONIA CELULARE</b> .....   | <b>7</b>  |
| III.1 Pjeset e tregut te operatoreve celulare.....                                 | 7         |
| III.2. Trafiku telefonik.....  | 11        |
| III.3. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare .....                         | 11        |
| <b>Sherbime te reja: 3G</b> .....  | <b>13</b> |
| <b>IV. TELEFONIA FIKSE</b> .....   | <b>15</b> |
| IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut.....                                 | 15        |
| IV.2. Struktura e thirrjeve dalese te Albtelecom.....                              | 17        |
| <b>V. INTERNETI</b> .....  | <b>18</b> |
| V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre..... | 18        |
| V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura.....               | 21        |

|  |           |
|--|-----------|
| <b>Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2012/1</b> .....                        | <b>5</b>  |
| <b>Figura 3. Krahasimi i normave te penetrimit: Shqiperi 2012/1 vs mesatare e BE- 27</b> .....                 | <b>6</b>  |
| <b>Figura 4. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2000-2012/1</b> .....                                     | <b>7</b>  |
| <b>Figura 5. Struktura e perdoruesve te telefonise celulare (2012/1)</b> .....                                 | <b>8</b>  |
| <b>Tabela 1: Struktura e perdoruesve celulare 2012/1</b> .....   | <b>9</b>  |
| <b>Tabela 2: Pjeset e tregut te operatoreve celulare 2011-2012/1</b> .....                                     | <b>10</b> |
| <b>Figura 6: Pjeset e tregut te operatoreve celulare grafike per 2012/1</b> .....                              | <b>10</b> |
| <b>Tabela 3: Perdorimi mesatar i sherbimeve celulare 2010-2012/1</b> .....                                     | <b>12</b> |
| <b>Tabela 4: Perdorimi i sherbimeve roaming nderkombetar 2011/1 dhe 2012/1</b> .....                           | <b>13</b> |
| <b>Tabela 5: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2012/1)</b> .....  | <b>14</b> |
| <b>Figura 6. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2012/1</b> .....                         | <b>15</b> |
| <b>Tabela 7 : Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2012/1)</b><br>..... | <b>16</b> |
| <b>Figura 7. Struktura e thirrjeve dalese te pajtimatreve te Albtelecom 2011/1-2012/1</b> .....                | <b>17</b> |
| <b>Figura 8: Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband fisk dhe 3G (2007-2012/1)</b> ..               | <b>18</b> |
| <b>Tabela 9: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2011-2012/1)</b> .....                   | <b>19</b> |
| <b>Tabela 10. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas sherbimeve 2012/1</b> .....                  | <b>21</b> |
| <b>Tabela 11. Te dhena per infrastrukturen e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2012/1</b><br>.....       | <b>22</b> |

## **I.HYRJE**

AKEP, me qellim informimin e publikut, paleve te interesuara dhe te sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike me treguesit kryesore te ketij tregu, ne vijimesi te raporteve periodike te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) ne seksionin Statistika, ka pergatitur kete raport ne te cilin publikohen treguesit kryesore te tregut per 6 mujorin e I-re 2012, si dhe ndryshimet me periudhat e meparshme.

Ky raport eshte pergatitur duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare, Albtelecom si dhe te dhenave te Operatoreve Alternative dhe Ofruesve te sherbimeve, sipas formuleve te Rregullores se te dhenave statistikore, te plotesuar nga sipermaresit e autorizuar nga AKEP. Per shkak te ruajtjes se konfidencialitetit te te dhenave, jo te gjithe treguesit e raportuar nga operatoret publikohen nga AKEP.

## II. PANORAME E PERGJITHSHME

Numri ne total i sipermarrësve te regjistruar ne AKEP ne perputhje me regjimin e autorizimit te pergjithshem deri ne fund te 6 mujorit te I-re 2012, rezulton te jete gjithesej 137.

Referuar “Rregjistrin të Sipërmarrësve” në lidhje me njoftimin për ofrim rrjetesh/shërbimesh gjendja ne perputhje me regjimin e autorizimit te pergjithshem, rrjete dhe shërbime te specifikuara deri ne në fund të 6 mujorit te I-re 2012, jane si me poshte:

- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi publik telefonik te levizshem (UMTS) (3G) – 2 sipermarres;
- Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm)– 82 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 115 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi transmetim te dhenash – 47 sipërmarrës;
- Ofrim të linjave me qera – 21 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi te kartave te parapaguara – 5 sipermarres;

Edhe gjatë 6 mujorit te I-re 2012, ne tregun e komunikimeve elektronike konstatohen ndryshime pozitive ne segmentet e e telefonisë celulare dhe të internetit, ndërsa për telefoninë fikse vihet re nje renie e vogel krahasuar me te dhenat fund vitit 2011.


Në fund të 6 mujorit te I-re 2012, numri i pajtimtareve te telefonise se levizshme (ne total) arriti ne afersisht 5.3 milion ne krahasim me 5.2 milion ne fund te vitit 2011, e cila perben nje norme penetrimit afersisht 187% kundrejt normes se penetrimit 185 %, qe ishte ne fund te vitit 2011.

Ne fund te 6 mujorit te I-re 2012, si dhe disa vleresimeve te bera nga AKEP, rezulton qe numri i pajtimtareve te telefonise fikse arriti afersisht 325 mije, nga te cilet 244 mije te Albtelecom dhe rreth 81 mije operatoret alternative.

Penetrimiti i telefonise fikse ne fund te 6 mujorit te I-re 2012 eshte afersisht 11.5 %, krahasuar me 12% qe ishte ne fund te vitit 2011.


Norma e penetrimit te telefonise fikse ne Shqiperi vazhdon te jete ne nivelin e 11.5%, qe përbën një normë shumë të ulët në krahasim me vendet e BE ( me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit.

**Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2012/1**



**Figura e mëposhtme paraqet ecurine e penetrimit (numri i perdoruesve per 100 banore<sup>1</sup>) të telefonisë celulare dhe fikse per periudhen 2003-2012/1.**

**Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2012/1**



<sup>1</sup> Numri i banoreve ne Shqiperi i referohet te dhenave te Instat per numrin e popullise (sipas Census 2011)


Sipas të dhënave të 6 muajorit të I-re 2012, nga Albtelecom, Operatorët alternativë si dhe të dhënave dy rrjetet 3G, konkretisht të Vodafone dhe AMC për numrin e pajtimtareve me akses në broadband nëpërmjet rrjetit 3G si dhe vlerësimeve të AKEP, rezultojnë se numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 175 mijë apo afërsisht 24 % e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 14.000 pajtimtarë biznesi.

Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë në fund të 6 muajorit të I-re 2012 është rreth 6.7 %, krahasuar me 6.2 % që ishte në fund të vitit 2011.

Normat e penetrimit të shërbimeve të telefonisë fikse dhe të aksesit apo linjave broadband janë shumë më të ulëta se në vendet e BE, megjithatë rritjen në aksesin broadband, ndërsa për telefoninë celulare norma e penetrimit është mbi nivelin mesatar të vendeve të BE.

Grafiku i mëposhtëm jep në mënyrë krahasimore normat e penetrimit në Shqipëri të shërbimeve të telefonisë fikse, celulare dhe aksesit broadband me vendet e BE.

**Figura 3. Krahasimi i normave të penetrimit: Shqipëri 2012/1 vs mesatare e BE- 27**



### III. TELEFONIA CELULARE

#### III.1 Pjeset e tregut te operatoreve celulare


Në fund të 6 mujorit të I-re 2012, numri i pajtimtareve të telefonisë së levizshme (në total) arriti në afërsisht 5.3 milion në krahasim me 5.2 milion në fund të vitit 2011, e cila përben një normë penetrimi afërsisht 187% kundrejt normës së penetrimit 185 %, që ishte në fund të vitit 2011. Në totalin e tyre, në fund të 6 mujorit të I-re 2012 ka një rritje prej rreth 55 mijë përdorues celulare krahasuar me fund vitin 2011 ose një prej afërsisht 1%.

Numri i pajtimtarëve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para aftit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë nëse do të referoheshim numrit të pajtimtarëve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (përdorues aktivë), numri i pajtimtarëve celularë në fund të 6 mujorit të I-re 2012 është 3,238,369 (norma e penetrimit do të ishte afërsisht 114%), krahasuar me 3,108,087 (norma e penetrimit 110%) në fund të vitit 2011.

Në tre rrjetet Vodafone, Eagle Mobile dhe Plus Communication gjatë 6 mujorit të I-re 2012 ka rritje të numrit të pajtimtarëve në rrjetet e tyre, perkatesisht me 1.65% Vodafone, 17.5% Eagle Mobile dhe 3.5% Plus Communication. Kurse rrjeti AMC ka një rënie në numrin e pajtimtarëve në fund të 6 mujorit të I-re 2012 krahasuar me fund vitin 2011, prej rreth 9.5 %.

Vodafone Albania është operatori më i madh në treg për sa i përket numrit të pajtimtarëve.

**Figura 4. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2000-2012/1**



Përdoruesit me parapagim vazhdojnë të përbëjnë më shumë se 90% të përdoruesve celularë dhe kjo strukturë abonentësh është e ngjashme në të katër operatorët.

Struktura e përdoruesve celularë edhe në 6 muajin e I-re 2012, në përdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate), vazhdon të jetë pothuajse e qëndrueshme si në periudhat e mëparshme, me ndryshime të vogla nga njëri rrjet në tjetrin, ku numri i përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve celularë, është afërsisht 10 %.

Pesha e përdoruesve me parapagim në strukturën e përdoruesve sipas secilit operator celularë, është konkretisht: 90.28 % në AMC, 94.08 % në rrjetin e Vodafone, 86.51 % në rrjetin Eagle Mobile dhe 86.51 % në rrjetin e Plus, duke ruajtur pothuajse të njëjten strukturë si në periudhat e mëparshme.

**Figura 5. Struktura e përdoruesve të telefonisë celularë (2012/1)**




Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për 6 muajin e I-re 2012, mbi numrin e pajtimtareve celularë të detajuar në abonentë Familjare dhe Biznes si dhe përdoruesit e shërbimeve të aksesit në Internet dhe pajtimtaret që kanë ndërruar program tarifor brenda të njëjtit operator, si dhe tregues të numrit të pajtimtareve që kanë përdorur shërbimin e portabilitetit të numrit në rastin e largimit nga rrjeti juaj si dhe të ardhjes në rrjetin tuaj sipas tabelës së mëposhtme.



Tabela 1: Struktura e perdoruesve celulare 2012/1

| <b>Detajime per pajtimtaret e telefonise celulare</b>  | <b>AMC</b>       | <b>VF-AL</b>     | <b>EAGLE</b>     | <b>PLUS</b>    |
|--|------------------|------------------|------------------|----------------|
| <b>Numri pajtimtareve te telefonise celulare ne total i detajuar:</b>                            | <b>1,736,660</b> | <b>1,839,214</b> | <b>1,304,553</b> | <b>410,764</b> |
| Perdorues familjare  | 1,622,331        | 1,798,046        | 1,082,071        | 358,723        |
| Perdorues biznes   | 114,329          | 41,168           | 222,482          | 52,041         |
| <b>Numri i pajtimtareve qe perdorin rrjetin celular per akses ne internet me GPRS/EDGE</b>       | <b>384,981</b>   | <b>268,789</b>   | <b>91,761</b>    | <b>84,262</b>  |
| <b>Numri pajtimtareve te telefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS(3G) ne total:</b> | <b>76,850</b>    | <b>231,441</b>   |                  |                |
| - nepermjet aparatit te telefonit celular  | 65,000           | 205,520          |                  |                |
| - nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)  | 11,850           | 25,921           |                  |                |
| <b>Numri i Pajtimtareve qe kane nderruar program tarifar</b>                                     |                  |                  | <b>32,834</b>    |                |
|  | <b>33,481</b>    | <b>47,917</b>    |                  | <b>3,564</b>   |
| <b>Numri i pajtimtareve qe kane nderruar operator (portabilitet numri)</b>                       | <b>23,097</b>    | <b>11,128</b>    | <b>20,260</b>    | <b>14,148</b>  |

Pjesët e tregut të operatorëve celularë janë vlerësuar në disa prej treguesve kryesore sipas të dhenave të depozituara në AKEP, të cilat janë të paraqitura sipas tabelave grafikeve të mëposhtem dhe që përmbajnë pjesë tregu për numrin total të pajtimtareve, sipas thirrjeve dalese si dhe numrit të SMS-ve të dërguara nga pajtimtaret e rrjeteve të tyre.

Nga vlerësimi i pjesëve të tregut si tregues për 6 mujorin e I-re 2012 për zerat: numer përdoruesish në total, thirrje dalese në total si SMS dalese në totale, rezultojnë që ka një rënie pjesëve të tregut për AMC në numrin e përdoruesve rreth 4% dhe një rritje të numrit të pajtimtareve për Eagle Mobile rreth 4%, si dhe një rritje të vogël për Vodafone Albania.

Ndërsa në lidhje me tregusit për thirrjet dalese situata paraqitet pëthuesisht e njëjta krahasuar me fund vitin 2011, duke reflektuar një rënie të vogël për Eagle Mobile si dhe një rritje jo të konsiderueshme për Plus Communication.


Vlen të theksohet që në vlerësimin e pjesëve të tregut për thirrjet dalese janë të përfshira edhe thirrjet on-net.

Në lidhje me pjesët e tregut për SMS dalese, rezultojnë që AMC ka një rënie të ndjeshme prej rreth 17%, ndërsa Vodafone Albania në këto tregues ka një rritje prej 21%. Rritje prej 3% rezultojnë edhe për Eagle Mobile, ndërsa operatori Plus Communication reflekton një humbje të pjesëve të tregut të fituara në SMS dalese në fund të vitit 2011.

Tabela 2: Pjeset e tregut te operatoreve celulare 2011-2012/1

|                |        | AMC    | VODAFONE ALBANIA | EAGLE MOBILE | PLUS COMMUNICATION |
|----------------|--------|--------|------------------|--------------|--------------------|
| Perdorues      | 2012/1 | 32.82% | 34.76%           | 24.66%       | 7.76%              |
|                | 2011   | 37%    | 34%              | 21%          | 8%                 |
| Thirrje dalese | 2012/1 | 37.08% | 50.92%           | 8.79%        | 3.21%              |
|                | 2011   | 37%    | 51%              | 10%          | 2%                 |
| SMS            | 2012/1 | 19.7 % | 72.92%           | 6.9 %        | 0.48 %             |
|                | 2011   | 37%    | 51%              | 10%          | 2 %                |

Figura 6: Pjeset e tregut te operatoreve celulare grafike per 2012/1



### **III.2. Trafiku telefonik**

Trafiku telefonik dales ne total ne fund te 6 mujorit te I-re 2012, krahasuar me fundin e 6 mujorit te I-re 2011 ka nje rritje ne rreth 22 %.

Ndersa e klasifikuar sipas thirrjeve dalese brenda rrjetit, thirrje dalese drejt rrjeteve te tjera celulare, thirrje dalese drejt rrjeteve fikse si dhe thirrje dalese nderkombetare ka nje rritje respektivisht ne vlerat: 21 %, 21%, 23%, 5.6% dhe 57 %, vlera keto te krahasuara me te dhenat e 6 mujorit te I-re 2011.

Terminimi i thirrjeve ne totalin e thirrjeve te terminuara ka nje rritje prej rreth 12 %, krahasuar me 6 mujorin e I-re 2011, ndersa terminimi i thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera celulare si dhe terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare ka nje rritje respektivisht sipas vlerave rreth 15 % dhe 12 %, vlera te krahasuara me 6 mujorin e I-re 2011.

Terminimi i SMS-ve ka nje rritje prej rreth 22 % krahasuar me 6 mujorin e pare 2011

### **III.3. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare**

Ne vijim eshte dhene nje tabele me te dhena per perdorimin mujor per perdorues celulare. Perdorimi mesatar mujor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga nje perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga nje perdorues), te matura ne minuta. Keta tregues jane llogaritur per te gjithe trafikun e gjeneruar dhe marre gjate periudhes pjestuar me numrin mesatar te perdoruesve gjate periudhes (mesatarja e numrit te perdoruesve ne fillim dhe ne fund te periudhes). Thirrjet dalese perfshijne gjithe trafikun e origjinar nga perdoruesit celulare ndersa thirrjet hyrese perfshijne thirrjet e marra nga perdoruesit, nga rrjete te tjera dhe nga i njeiti rrjet. Perdorimi mujor i SMS i referohet vetem mesazheve te derguar. Keto te dhena paraqiten ne tabelen e meposhtem per perdorimin mesatar te nje perdoruesi celular, i perlllogaritur me te dhenat e tre operatoreve celulare.

Ne 6 mujorin e I-re 2012 vihet re tendenca e rritjes se perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike si dhe sherbimit te SMS-se.

MOU ne fund te 6 mujorit te I-re te 2012, tregon qe nje perdorues celular ka kryer mesatarisht 92 minuta thirrje dalese dhe ka marre 102 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar ne 194 minuta komunikim ne muaj ( rreth 9.6 % me shume se ne vitin 2011) dhe ka derguar rreth 19 SMS ne muaj (58 % me shume se ne 2011).

Treguesit ne rritje shprehin rritjen e perdorimit te sherbimeve celulare per perdorues gjate 6 mujorit te I-re 2012.

Tabela 3: Perdorimi mesatar i sherbimeve celulare 2010-2012/1

|  | 2010       | 2011       | 2012/1     | Ndryshimi %<br>(2012/1 dhe 2011) |
|--|------------|------------|------------|----------------------------------|
| <b>Thirrje dalese ne muaj</b>            | 80         | 83         | 92         | 10.8 %                           |
| <b>Thirrje te marra (hyrëse) ne muaj</b> | 90         | 94         | 102        | 8.5 %                            |
| <b>MOU2</b>                              | <b>170</b> | <b>177</b> | <b>194</b> | <b>9.6 %</b>                     |
| <b>SMS (dalëse) ne muaj</b>              | 10         | 12         | 19         | 58 %                             |

#### - Roaming Nderkombetar

Tabela e meposhteme paraqet perdorimin e sherbimeve roaming per 6 mujorin e I-re 2012 dhe jane te krahasuara me te dhenat e 6 mujorit te I-re 2011 , nga te cilate vihet re se:

Numri i abonenteve te rrjeteve Shqiptare qe kane perdorur roaming nderkombetar gjate 6 mujorit te I-re te vitit 2012 ishte mbi 422 mije , ndersa numri i vizitoreve (abonente te rrjeteve te huaja) qe kryejne roaming ne Shqiperi (mbi 2 milion). Te dy treguesit kane rritje krahasuar me gjashtemujorin e pare 2011, por vihet re qe sherbimi roaming per vitin 2012/1 krahasuar me vitin 2011/1 ka nje rritje te konsiderueshme kryesisht per pajtimtaret e rrjeteve te huaja qe perdorin roamingun ne Shqiperi me nje rritje rreth 44 %. Faktoret e rritjes mund te kene lidhje si me efektin e levizjes se lire gjithashtu edhe me prezencen e turisteve ne sezonin turistik

Konsumi i sherbimeve gjate kohes se qendrimit ne roaming edhe per 6 mujorin e I-re 2012 eshte i vogel, pavaresisht rritjes se numrit te perdoruesve, niveli i perdorimit ka nje renie krahasuar me 6 mujorin e I-re 2011. Kryesisht vihet re qe perdorimi i sherbimit roaming nga vizitoret e rrjeteve te huaja ne Shqiperi eshte me i madh se perdorimi i roamingut nderkombetar nga pajtimtaret shqiptare.

<sup>2</sup> Minutes Of Use: Minuta perdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse.

**Tabele 4: Perdorimi i sherbimeve roaming nderkombetar 2011/1 dhe 2012/1**

|   | <b>2011/1</b>    | <b>2012/1</b>    |
|---|------------------|------------------|
| Perdorimi nga pajtimtaret e rrjeteve Shqiptare i Roamingut Nderkombetar               |                  |                  |
| <b>Numri i pajtimtareve</b>   | <b>403,818</b>   | <b>422,561</b>   |
| Perdorimi nga pajtimtaret e rrjeteve te huaj gjate Roamingut Nderkombetar ne Shqiperi |                  |                  |
| <b>Numri i pajtimtareve</b>   | <b>1,454,878</b> | <b>2,092,757</b> |

### **Sherbimi mesazheve MMS**

Perdorimi i sherbimeve MMS per vitin 2012/1 , eshte ne nivel shume te kufizuar me rreth 222 mije MMS te derguara dhe te marra nga abonentet gjate 6 muajve, qe perben konsum shume te vogel mujor. Krahasuar me vitin 2011/1, ne te cilin MMS te derguara dhe te marra rezultonin rreth 361 mije, vihet re nje renie e ndjeshme e perdorimit te sherbimit te MMS-se nga pajtimtaret e telefonise celulare, nje renie rreth 62% krahasuar me 2011/1.

### **Sherbime te reja: 3G**

Aktualisht ne tregun e sherbimeve 3G jane prezent dy rrjete celulare Vodafone Albania dhe AMC. Referuar te dhenave te derguara per 6 mujorin e I-re 2012, rezulton qe numri i pajtimtareve qe aktualisht perdorin sherbime 3G eshte mbi 308 mije nga te cilet rreth 38 mije perdorin sherbimet 3G nepermjet card/modem, ndersa pjesa tjeter nepermjet aparatit te telefonit celular. Krahasuar me 6 mujorin e I-re 2011 periodhe ne te cilen ishte prezent me sherbime 3G vetem Vodafone Albania, ne fund te viti 2011 dhe 6 mujorin e I-re 2012 ka ne vijimesi rritje te numrit te pajtimtareve ne sherbime 3G, por edhe vihen re elementet e reja ofertuese per keto sherbime nga dy operatoret prezent ne treg.

Vihet re qe numri i perdoruesve qe pedorin sherbimet 3G me karta modem/USB 3G, gje e cila lejon aksesin ne internet nepermjet PC eshte rreth 38 mije qe perben rreth 21 % te pajtimtareve total (fiks dhe 3G) me akses broadband ne Shqiperi.

**Tabela 5: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2012/1)**

|  | <b>AMC</b>    | <b>VODAFONE</b> | <b>TOTAL</b>   |
|--|---------------|-----------------|----------------|
| Numri pajtimtareve tetelefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS ne total: | <b>76,850</b> | <b>231,441</b>  | <b>308,291</b> |
| - nepermjet aparatit te telefonit celular  | 65,000        | 205,520         | 270,520        |
| - nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)                                  | 11,850        | 25,921          | 37,771         |

## IV. TELEFONIA FIKSE

### IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut


Telefonia fikse në ndryshim nga telefonia celulare dhe Interneti, ka pësuar rënie në numrin e pajtimtarëve, dhe vazhdon të ketë një penetrim shumë të ulët.

Në fund të 6 mujorit të I-re 2012, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse arriti në rreth 325 mijë, nga të cilët 244 mijë të Altelecom dhe rreth 81 mijë pajtimtare për operatorët alternativë. Vihet re një reduktim në krahasim me rreth 339 mijë që ishin në fund të vitit 2011. Ky reduktim është afërsisht rreth 14 mijë pajtimtare dhe erdhi si rezultat i reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Altelecom me rreth 15 mijë pajtimtare, por sic vihet re ka një rritje të vogël të numrit të pajtimtarëve të rrjeteve të operatorëve alternativë.

Referuar këtyre të dhënave, rezultojnë se penetrimi i telefonisë fikse në fund të 6 mujorit të I-re 2012 është afërsisht 11.5 %, krahasuar me 12% që ishte në fund të vitit 2011.

Megjithatë rënien e numrit të pajtimtarëve të Altelecom, perseri zotëron rreth 75 % të këtij tregu me rreth 244 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 25 % me rreth 81 mijë pajtimtarë.

**Figura 6. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2012/1**



Vihet re qe referuar te dhenave te 6 mujorit te I-re 2012, operatoret Abcom, ASC, Nisatel, Primo dhe AMC Fiks (qe ka filluar ne Dhjetor 2011 ofrimin e sherbimit te telefonise fikse me numra fiks duke perdorur rrjetin GSM) jane pese operatoret alternative me te medhenj qe zoterojne rreth 67 % te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse te operatoreve alternative, apo e thene ndryshe zene rreth 17 % te totalit te pajtimtareve te telefonise fikse. Dy prej operatoreve Abcom dhe Nisatel reflektojne nje rritje te numrit te pajtimtareve krahasuar me te dhenat e fund vitit 2011, respektivisht me 19 % dhe 5 %.

Ndersa te gjitha rrjetet e tjera kryesore te telefonise fikse reflektojne renie ne % krahasuar me te dhenat e fund vitit 2011, perfshire dhe operatorin AMC Fiks. Renie te ndjeshme vihet re te kete operatori ASC, i cili eshte nje nder dy operatoret alternative se bashku me Abcom qe aktualisht jane prezent ne treg me oferta 'triple play' duke ofruar Internet broadband, telefoni dhe TV. Abcom vazhdon te jete operatori me i madh alternativ fiks me mbi 32 mije pajtimtare.

**Tabela 7 : Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2012/1)**

|                           | Albtelecom | Abcom  | ASC    | Nisatel | Primo | AMC Fiks | OA te tjere (afersisht) | Total   |
|---------------------------|------------|--------|--------|---------|-------|----------|-------------------------|---------|
| <b>2011</b>               | 258,943    | 27,167 | 10,129 | 4,950   | 3,300 | 7,565    | 27,000                  | 339,000 |
| <b>6 mujori I-re 2012</b> | 244,000    | 32,437 | 6,677  | 5,200   | 3,094 | 7,275    | 26,500                  | 325,000 |
| <b>Ndryshimi ne (%)</b>   | -6         | 19     | -34    | 5       | -6    | -4       | -2                      | -6      |

Ne lidhje me pjesën e tregut te thirrjeve te origjinuara, Albtelecom edhe ne 6 mujorin e I-re 2012 mbi 90 % të thirrjeve te origjinuara drejt te gjitha rrjeteve per sektorin e telefonisë fikse.

Thirrjet dalëse të përdoruesve të Albtelecom janë kryesisht thirrje lokale, ku edhe ne 6 mujorin e I-re 2012 zene mbi 75 % te tyre.


Ndër operatorët alternative vecohet opearatori Abcom , i cili ruan trendin rrites te periudhave te meparshme, ku edhe per gjashtëmujorin e pare të vitit 2012 ka nje rritje prej 19 % krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012, duke zene keshtu pjese tregu ne termat e pajtimtareve rreth 10% te numrit total te pajtimtareve te telefonise fikse. Shebimet e ofruara me paketa dyfishe dhe tre-fishe (internet, telefoni dhe TV), duke arritur rreth 20 mijë pajtimtarë dhe duke bërë që të jetë zotërues i rreth 10 % të tregut të telefonise fikse dhe mbi 16 % në akses Internet broadband.



## IV.2. Struktura e thirrjeve dalese te Altelecom

Figura e meposhteme paraqet strukturen e thirrjeve dalese te pajtimtareve te Altelecom ku vihet re se thirrjet lokale perbejne nje pjese te konsiderueshme te thirrjeve dalese mbi 75%, ndersa thirrjet nderkombetare dhe drejt rrjeteve celulare perbejne nje pjese shume te vogel me me pak se 10%. Struktura e thirrjeve dalese nuk paraqet ndryshime nga periodhat e meparshme.

Figura 7. Struktura e thirrjeve dalese te pajtimtareve te Altelecom 2011/1-2012/1



## V. INTERNETI

### V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre


Sherbimi i internetit vazhdon te kete trend rrites edhe ne 6 mujorin e I-re 2012. Referuar te dhenave statistikore të 6 mujorit te I-re 2012, nga Albtelecom, operatorët alternative, te Vodafone dhe AMC per numrin e pajtimtareve me akses ne broadband 3G (me karta USB/modem) si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton qe umri i pajtimtareve ne total me akses ne broadband internet ne te gjitha rrjetet ofruese te sherbimit te internetit, te jete afersisht 189 mije. Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banore ne fund te 6 mujorit te I-re 2012 është rreth 6.7 %, krahasuar me 6.2 % që ishte në fund të vitit 2011.

Numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 175 mije apo afërsisht 24 % e familjeve, kundrejt 161 mije familjeve apo afërsisht rreth 22 % ne fund te vitit 2011.

Numri i pajtimtareve te biznesit me akses ne broadband internet edhe per 6 mujorin e I-re 2012 eshte pothuajse ne te njejten vlere si ne fund te vitit 2011 dhe vlerësohen të jenë mbi 14.000 pajtimtarë biznesi.

Figura e mëposhtëme paraqet ecurine e numrit të pajtimtarëve me akses broadband (fiks dhe 3G) në periudhen 2007-2012/1.

**Figura 8: Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband fisk dhe 3G (2007-2012/1)**



Numri i pajtimtareve me akses broadband fiks ne gjashtemujorin e pare 2012 ishte rreth 151 mije qe perben nje rritje me rreth 9% ne krahasim me fund vitin 2011. Ndersa numri i pajtimtareve me akses broadband qe perdorin 3G-USB/modem ishte rreth 38 mije nga rreth 35 mije ne fund vitin 2011, apo nje rritje me 9.5%.

Ne vijim eshte tabela e shperndarjese se pajtimtareve me akses ne broadband internet per te gjitha rrjetet ofruese te ketij sherbimi si dhe krahasimi me te dhenat e fund vitit 2011.

**Tabela 9: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2011-2012/1)**

|                           | Albtelecom | Abcom  | Abissnet | ASC    | Primo | OA te tjere | AMC    | Vodafone | Total Fiks +3G |
|---------------------------|------------|--------|----------|--------|-------|-------------|--------|----------|----------------|
| <b>2011</b>               | 60,055     | 29,321 | 15,321   | 10,129 | 4,381 | 20,490      | 9,000  | 25,493   | <b>174,190</b> |
| <b>6 mujori I-re 2012</b> | 65,393     | 29,321 | 15,296   | 10,134 | 5,662 | 24,961      | 11,850 | 25,921   | <b>188,538</b> |
| <b>Ndryshimi ne (%)</b>   | 8.9%       | 0.0%   | -0.2%    | 0.0%   | 29.2% | 21.8%       | 31.7%  | 1.7%     | <b>8.2%</b>    |

Ne shumice e rrjeteve ofruese te aksesit ne broadband internet vihete re nje rritje e numrit te pajtimtareve, ku mund te vecohen dy rrjete me rritjen me te medha si AMC, Primo dhe Nisatel, perkatesisht me 31.7% , 29.2% dhe 24% krahasuar me te dhenat e fund vitit 2011. Theksojme se AMC eshte ofrues i sherbimit 3G dhe ne fund te vitit 2011 sapo kishte lancuar sherbimin 3G, keshtu te dhenat e 6 mujorit te I-re 2012 reflektojne nje faze rritje te numrit te pajtimtareve ne kete rrjet dhe se ne kete vleresim jane perfshire vetem pajtimtaret me akses qe perdorin 3G-USB/modem, e cila mundeson perdorimin e internet broadband ne PC.

Albtelecom ne ndryshim nga telefonia fikse qe kishte renie ne numrin e pajtimtareve, ne sherbimin e aksesit ne broadband internet ne fund te 6 mujorit te I-re 2012 krahasuar me te dhenat e fund vitit 2011 ka nje rritje prej rreth 9%.

Rritja e numrit te pajtimtarëve qe kane akses ne broadband internet per disa nga rrjetet e operatorëve alternativë dhe te Albtelecom reflektohet edhe ne pjesët e tregut të tyre. Albtelecom ka ruajtur pjesen e tregut për aksesin broadband fiks ne nivel 43% te njejte me fund vitin 2011.

Kjo vihete re kryesisht nga qe aksesit broadband nga rrjetet celulare ka filluar të japë efektet pozitive pasi te dy operatorët Vodafone dhe AMC edhe pse per nje kohe jo shume te gjate ne treg, kanë arritur të kene rreth 37 mijë abonentë qe kane akses ne broadband me karta USB/modem 3G, që përbejne mbi 20 % të numrit total të pajtimtarëve broadband (fiks dhe celularë).

Ndërsa numri i pajtimtarëve celularë të këtyre dy operatorëve që përdorin shërbimin e internetit broadband nëpërmjet aparateve telefonike është rreth 270 mijë në fund të 6 mujorit te I-re 2012 nga rreth 250 mije qe ishte ne fund te vitit 2011.

Figura 9: Pjeset e tregut per akses broadband 2012/1 (Fiks dhe Mobile)





Figura 10: Pjeset e tregut per akses broadband 2012/1 (Fiks)



Ne teresine e tyre nje numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri.

Trendi i ndryshimeve cilësore ne ofrimin e shërbimit te internet broadband si dhe reduktime te tarifave në ofrimin e aksesit broadband në Internet, kane vazhduar edhe ne periudhen e 6 mujorit te I-re 2012.

Shpejtesia me perdorur eshte rritur nga 1-2 Mbps ne 2-4 Mbps.

Operatoret kryesore kane oferta edhe per shpejtesi me te larta 4-20 Mbps.

**Tabela 10. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas shërbimeve 2012/1**

|  | Alternative           | Albtelecom         |
|--|-----------------------|--------------------|
| <b>Shpejtesia e aksesit ne Internet</b>  | 256 kbit/s- 20 Mbit/s | 2 Mbit/s-12 Mbit/s |
| <b>Shpejtesia me e perdorur</b>  | 1-2 Mbit/s            | 2 - 4 Mbit/s       |
| <b>Numri i pajtimtareve qe kane akses ne shërbime te integruara te specifikuara:</b> |                       |                    |
| <b>TV, Internet dhe Telefoni</b>   | 3744                  | 0                  |
| <b>TV dhe Internet</b>   | 4651                  | 0                  |
| <b>Internet dhe Telefoni</b>   | 36538                 | 65393              |

## **V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura**

Referuar te dhenave te 6 mujorit te I-re 2012, rezulton qe infrastruktura qe e cila mundeson aksesin ne broadband për pajtimtarët, ka pesuar ndryshime te vogla krahasuar me te dhenat e fund vitit 2011.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna ne lidhje me infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët per rrjete me fiber optike dhe lidhjen me Internetin global (lidhje me boten).

Nga të dhënat vihet re se konektiviteti me Internetin Global ne fund te 6 mujorit te I-re 2012 eshte i njejte me te dhenat e fund vitit 2011, ne rreth 30 Gbps.

Gjatesia e fibres optike te instaluar nga operatoret eshte aferisht 5700 km nga rreth 4600 ne fund te vitit 2011.

Ne lidhje me numrin e Internet kafeve qe marrin akses nga ISP-te, rezulton pa ndryshime te ndjeshme me periudhat e meparshme ne rreth 1100.

**Tabela 11. Te dhena per infrastrukturen e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2012/1**

|  | <b>Alternative</b> | <b>Albtelecom</b> | <b>Total</b> |
|--|--------------------|-------------------|--------------|
| <b>Konektiviteti me Internetin Global -Lidhje nderkombetare (Gbps)</b> | 10                 | 20                | 30           |
| <b>Fibër Optike e instaluar (gjatesia km)</b>                          | 2800               | 2837              | 5637         |